

AUTOBIOGRAFI

MBI EDUKIMIN DHE EKSPERIENCEN PROFESIONALE

Emri: **ARBEN KASO**

Datelindja: **19 Korrik 1952.**

Vendlindja: **TIRANE**

Adresa: **Rruga "Lidhja e Prizrenit", P/1, Apt. 7 Tirane**

Kam mbaruar shkollen e larte ne Universitetin e Tiranes, me 1975 dhe kam mbrojtur Diplomen me nr-2852-B dt 15-v-1976 e numer regjistri 257/3, po ne kete Universitet, pas praktikes mesimore, per Ndertime Civile Industriale Ura.

Ne 15 Gusht 1975 jam emeruar ne Ndermarjen e Mirembajtjes Rruga-Ura ne Pogradec, ku punova deri ne fund te ketij viti, duke kryer detyren e Pergjegjesit teknik te kesaj ndermarje. Ketu kam drejtuar punime per mirembajtjen e te gjisha rrugeve nacionale e rurale ne juridikcionin e rrethit te Pogradecit. Ne kete pozicion kam drejtuar punime per hapjen e rrugeve te reja rurale, apo per qellime te ndryshme, per asfaltimin e rrugeve dhe per organizimin dhe formulimin e impianteve te fraksionimit te inerteve e prodhimit te asfalto-betonit per kete ndermarje.

Ne fund te vitit 1975 dhe ne filim te vitit 1976 me kerkesen time emerohem Inxhinjer prane Ndermarjes se Ndertimit (N.N.) Pogradec, ne drejtimin teknik te punimeve te ndertimit per mbrojtjen dhe stabilizimin e reshqitjes masive te shpatit malor ne Gurin e Kuq Pogradec, e cila pengonte seriozisht ndertimin e Fabrikes se Pasurimit te Hekur-Nikelit ne kete vend. Ketu kam drejtuar punimet e ndertimit te perdeve mbrojtese me palankola mure mbajtese dhe vepra te tjera ndihmese si tunele e kanale per sistemimin e ujrale siperfaqesore ne kete territor.

Pasi perfundoj stazhin mesimor ne Maj te vitit 1976, mbroj diplomen dhe marr Titullin Inxhinjer. Me pas rikthehem prane N.N. Pogradec per te rifilluar perseri punen.

Ne Gusht te vitit 1976 emerohem Inxhinjer prane kantjerit te prodhimit te materialeve te ndertimit ne N.N.Pogradec. Ne kete kantjer, kam punuar per hapjen dhe shfrytezimin e karjerave te guroreve, me shperthime masive, si dhe per ndertimin e nyjeve te fraksionimit te inerteve. Po ketu kam punuar per

prodhimin inerteve, betoneve, elementeve parafabrikat prej beton-armeje, si trare, kolona, bunkere, etj., si dhe elementeve te tjere metalake si kapriata, trare, kolona e kulle ashensori per minerale.

Po per llogari te kesaj ndermarje shkoj ne 1979 ne Lezhe ne ndihme te zhdukjes te pasojave te termetit.

Ne Nentor – Dhjetor te vitit 1981, me vendim te Ministrise se Ndertimit, per kualifikimin pasuniversitar te punnjesve pa shkeputje nga puna, marr pjesë ne kursin kualifikues prane Institutit te Projektimeve nr-4 Tirane per llogaritjet e konstruksionit.

Ne Prill te vitit 1982 me urdher te Ministrise te Ndertimit emerohem ne Institutin e Studimeve dhe Projektimeve Nr-1 ne Tirane, me detyre konstruktor ne Sektorin e Konstruksioneve (si konstruktor, apo strukturist). Ne kete sektor, kam projektuar spitale, hotele, shkolla, shtepi pushimi, pallate kulture, objekte sportive, objekte industriale, buqesore, banesa publike, vila, rikonstruksione te ndryshme, e vepra te tjera te ndertuara ne pjesen me te madhe te territorit te Shqiperise.

Keto projekte gjenden ne arkivin e Institutit te Studimeve e Projektimeve nr-1, ose sot mund te jene ne Arkivin Qendoror te Ndertimit.

Po gjate kesaj kohe qe kam punuar ne kete Institucion, kam bere studime te ndryshme sipas detyrave te kohes, jam mare e kam studiuar:

- Nyjet e bashkimit te elementeve te parafabrikuar prej beton-armeje,
- Hapin optimal te kollonave ne godinat e banimit te ndertuara me skelet beton-arme,
- Kam qene anetar ne grupin e I.S.P. Nr-1, per hartimin e broshurave, apo flet-palosjeve, per riparimin e defekteve te pesuara nga goditja sizmike, ne ndertesat egzistuese.
- I ngaruar po nga ky Institut kam hartuar nje kumtese per masat anti sizmike qe jane perdorur nga ndertuesit e vjeter ne banesen e vjeter Gjirokastrite.

Gjate periudhes, qe Une kam punuar ne kete Institut, jam derguar dhe kam punuar, per evidetimin vleresimin dhe zhdukjen e pasojave, qe jane krijuar ne rrethe te ndryshme te vendit, nga fatkeqesite natyrore, si permbytjet ne Lushnje Fier, rreshjet e debores ne zonen veri-lindore, apo termetet e ndodhura gjate kesaj periudhe ne Lushnje-Fier, Tirane, Tropoje, Gjirokaser. Ne keto aksione ne kemi evidentuar, vleresuar, e kemi dhene sugjerime lidhur me masat qe duhen marre per eleminimin dhe zhdukjen e ketyre pasojave. Po keshtu kam qene pjesë e grupit supervizor, si perfaquesues teknik i I.S.P. Nr-1.

Per sa eshte paraqitur me siper materialet kane qene ne dokumentacionet, shkesat zyrtare, apo ne projektet e ruajtura ne arkiven e I.S.P. Nr-1.

Ne vitet 1992-1993 vazhdoj karrieren time, si profesionist i lire privat, ne sherbim te disa kompanive private, te krijuara mbas vitit 1990, si "Besa" sh.p.k., "Ecki-92" sh.p.k., "Hoxholli" sh.p.k., duke sherbyer si drejtues teknik dhe projektues konstruktor ne keto kompani, duke drejtuar punime ndertimi, ne banesa, hotele, lokale sherbimi, qendra shendetesore, zyra, ndertuar ne qytetet: Tirane, Durres, Kavaje, Fier, Vlore, Sarande, Shkoder etj.

Ne vitet 1993-1994 kam punuar per "2K Goup", si konstruktor i kesaj kompanie, ku kam projektuar banesa, vila, zyra, pika karburanti, nyje franksionimi inertesh, lokale sherbimi, etj., qe mund te jene prane 2K Goup.

Ne vitin 1994, pas nje bashkepunimi me Universitetin e "Austinit" ne Texas, SHBA, per punet e mia, kam marre vlersimet e ketij te fundit te konfirmuara nga R.A Watkins "A Director".

Ne vitin 1994, ne bashkepunim me 3 ortake te tjere, krijuam Shoqerine Ndertuese "Pegaso" sh.p.k. Ne perberje te kesaj kompanie kam kryer, projekte e ndertime, si: rikonstruksione, per "Masey Ferguson" ne objektin e veglave bujqesore; per zyrat e Fondit te Zhvillimit Rural; per Kopeshtin 29 – financim i Fondacionit Soros; Spitalin e burgut; ndertime te reja si bllok banimi ne rrugen "Sytki Cico"; bllok banimi ne rrugen "Sami Frasherri" prane shkilles "Edit Durham"; bllok banimi "Savo" ne Golem, Kavaje; banese ne rrugen "Abdyl Frasherri"; banese ne rrugen "Ismail Qemali"; banese ne rrugen "Themistokli Germanji"; banese ne rrugen "Siri Kodra"; vila ne rrugen "Pjeter Bogdani"; vile ne rrugen "Riza Cerova"; etj., objekte te ndertuara deri ne vitin 2005-2006.

Gjate kesaj kohe, kam projektuar e supervizuar, per nje numer te madh kompanish ndertimi si: "Real" sh.p.k.; "Ormars" sh.p.k.; "Jali" sh.p.k.; "Limem"; "Morko" sh.p.k.; "N&H"; "Dea"; "Meld" sh.p.k.; "Rafaelo" sh.p.k.; "Beta" sh.p.k.; "Dola" sh.p.k.; Fondacionin "Soros"; "F.ZH.R"; "Rinia 04"; per studio arkitekturë arkitekt e investitore te ndryshem shqiptare e te huaj.

Ne vitin 2006, ne bashkepunim me kompanine Amerikane te ndertimit "Hitt", kam punuar per ndertimin dhe rikonstruksionin e ambjenteve ndihmese nentokesore, te selise se Perfaqësise Diplomatike te Shteteve te Bashkuara te Amerikes, ne Shqiperi.

Ne vitin 2006 me kerkese te kompanise Shqiptaro-Amerikane "Vista Group" sh.p.k. emerohem si drejtor per problemet teknike, projektin dhe supervizionin e ndertimit te komplekseve te vilave ne "Mhyll-Bathore" Komuna "Farke", ku kam

udhehequr projektimin, supevizionin dhe ndertimin e ketyre vilave, si dhe kam sherbyer si konsulent teknik i kesaj kompanie.

Ne Gusht te 2009 marr vleresimin dhe njehsimin e te gjitha rezultateve te mia mesimore, si dhe njehsimin perfundimtar te Diplomes Shqiptare, ne nivelin U.S Bachelor Degree in Civil Engineering.

Per kualifikim tim profesional, kam mare pjesë ne seshonet skencore, te organizuara nga: Shoqata e Gjeoteknikeve Shqiptare; Instituti Ndertimit Privat ne Tirane; Instituti Shteteror i Teknologjise se Ndertimit; per shqiperimin e "EuroKodit", ku kam mbajtur oponencen e pjeses se pare. Kam ndjekur kurse kualifikimi per kompjuter ne "AutoCAD 2 D" e "3 D" dhe "Structures Analysis Program" (SAP 2000), prane Institutit "Harry T Fultz" Community College.

Ne edukimin tim per gjuhet e huaja kam mesuar gjate sistemit arsimor gjuhen Ruse, autodidakt gjuhen Italiane dhe ne Sh.B.A gjuhen Angleze.

Qe nga viti 1982 edhe deri aktualisht, kam udhehequr dhe vazhdoj te udheheq studente, ne punimet e tyre te diplomave per mbrojtjen e Titullit Inxhinier prane Fakultetit te Inxhinierise se Ndertimit te Universitetit te Tiranes.

Pergatitur sipas burimeve arkivore.

Me respekt autorë

Ing. ARBEN KASEM KASO